



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës

KONTRATË PËR SHERBIME

KOMUNA E ISTOGUT, ZYRA E PROKURIMIT, të cilën e perfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z. Zizë Bujupaj, Rruga "Fadil Ferati" në njérën anë; dhe

NNT "Loshi Design" me NRB 70689324 me pronar Valmir Loshi, nga Gurrakoci, Komuna e Istogut, ne cilësinë e drejtorit të ndermarrjës nga ana tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për:

TITULLI I KONTRATËS

MIRËMBAJTJA E STADIONIT TË QYTETIT TË ISTOGUT

Nr. i prokurimit	633 – 018 -1138 -2-3-6 C90	
I brendshëm	633-018-010 -236	C90

Neni 1 Lënda

1.1 MIRËMBAJTJA E STADIONIT TË QYTETIT TË ISTOGUT

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **05. 04. 2018** dhe perfundon me **31.12.2018**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se dita **31.12.2018** nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerjes se sherbimeve do te jetë "**STADIONI I QYTETIT TË ISTOGUT**"

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **4.888,00 €;**
Me shkronja "Katërmijë/Tetëçind/Tetëdhjetë/PTetëeuro"

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtronen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2. Autoriteti Kontraktues do ta paguaj shumën totale te pagesës pas kryerjes së sherbimeve

4.3. Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përpüthje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i puneve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të Sherbimeve

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i kryeje njëren ose të gjitha sherbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërrmet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punimeve, deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshterinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshteria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktajoj pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik përvendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, osc vendim arbitrim.




13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Gjykata Themelore - Departamenti per Çështje Ekonomike*.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jep Titullin e kontratës dhe numrin i identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë. E hartuar në gjuhen Shqipe dhe Serbisht në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	<i>Valmir Loshi</i>	Emri:	<i>Zizë Bujupaj</i>
Pozita:	<i>Prokuror</i>	Pozita:	<i>Menaxher e Prokurimit</i>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	<i>05.04.2018</i>	Data:	<i>5.4.2018</i>
Vula:		Vula:	

Sekcioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

KOMUNA E ISTOGUT					
Mirembajtja e stadiumit te futbollit					
KOMUNA E ISTOGUT					
	Specifikimi i punëve	Njësia	Sasia	Cmimi/ Njesi	TOTALI
1	Demolimi I tribinave dhe bartja e materialit ne deponi	aprox	aprox	23,00	23,00
2	Meremetimi-drrasimi I tribinave me drrasa ne gjeresi 15 cm drrasat duhet te jene te ngjyrosura ,drrasat duhet te perforcohen me bullona.	M3	5	150,00	750,00
3	Furnizimi dhe shpërndarja e plehit artificial UREA	Kg	150	1,00	150,00
4	Furnizimi dhe shpërndarja e plehit azotik KAN	Kg	250	1,00	250,00
5	Ushqimi foljar i gjethëve ushqimi duhet te behet varësisht nga faza e zhvillimit te barit	L	60	1,00	60,00
6	Furnizimi dhe shpërndarja e rërës nr 00,1 ne tere sipërfaqen e fushës se futbollit	M3	15	20,00	300,00
7	Furnizimi me Humus - Kompost i dheut për bare si dhe te behet shpërndarja e tij	kg	400	0,50	200,00
8	Rollne bari për te vendosur ne vendet e dëmtuara ne fushën e futbollit	m2	20	215,00	4300,00
9	Nivelizimi i terenit ngjeshja e tij me cilindër me peshe 1000- 1200 kg ne dimensionet e fushës 100x70 m. Fusha duhet te cilindrohet 15 here pas çdo ndeshje .	Cope	14	55,00	1350,00
10	Ngjyrosja e portave te futbollit me ngjyre baze dhe ngjyre përfundimtare e bardhe dimensione e portës 7.20x2.44 m.	Cope	2	150,00	300,00
11	Tush bateri	Cope	5	25,00	125,00
12	Karrika per zhveshtore	Cope	46	25,00	1150,00
13	Topa futballi per zhvillimin e ndeshjeve kampionale (topi per loje)	Cope	5	50,00	250,00
TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT					
6'888,00					

